



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2021:003726

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05411757

P.nr.174/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm-Dvizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Shefqet Baleci, me pjesëmarrjen e procesmbajtëses Elheme Kastrati, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.Xh nga Drenasi, rruga “...” nr..., për vepër penale Vjedhje e shërbimeve, të parashikuar nga neni 314 par.6. lidhur me par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamentit të Përgjithshëm PP.II.nr.4897/2020, datë.30.12.2020, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, për dhënien e urdhrin ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, dënim me gjobë, PP.II.nr.4897/2020, datë.30.12.2020, me datë.**05.03.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET KËRKESA E PROKURORISË THEMELORE-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM në Prishtinë PP.II.nr.4897/2020, datë.30.12.2020, dhe gjykata jep këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I AKUZUARI: B.Xh, i biri i ... dhe i ..., e gjinisë ..., i lindur më datë ... në Drenas, ku edhe e ka vendbanimin rruga “...” nr..., me numër personal ... , Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: me datë 15.07.2020, në shtëpinë e tij në Drenas, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të shërbimit komunal, i akuzuari kishte keqpërdor energjinë elektrike, në atë mënyrë që, kishte bërë kyçje të drejtëpërdrejtë në rrjetin elektrik jashtë njehsorit elektrik-orëmatësit, duke pamundësuar regjistrimin e saktë të shpenzimeve të energjisë elektrike, si pasojë e kësaj të dëmtuarës KEDS Distrikti në Prishtinë, sipas shërbimit të faturimit i kishte shkaktuar dëme në shumë prej 114.22 €-

-me këtë ka kryer vepër penale Vjedhja e shërbimeve, të parashikuar nga neni 314 par.6. lidhur me par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj gjykata në bazë të nenit 4,7,17,21,38,43,69 dhe nenit 314 par.6. lidhur me par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe neneve 495,359,360,364,449 par.2.6. dhe par.3. dhe 462 par.2. të Kodit të Procedurës Penale (KPP), e:

G J Y K O N

Të akuzuarin B.Xh ME DËNIM ME GJOBË në shumë prej **140 (njëqind e dyzetë) €**, të cilin detyrohet të e paguaj në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari B.Xh në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të e zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) ditë.

Kur dënim me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, njëzetë (20) € gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.3. të KPRK-së.

Nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg. Kur dënim me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, njëzetë (20) € gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.3. të KPRK-së.

Nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën në tërësi, gjykata do të zëvendësojë pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, siç parashihet në paragrafin 3 të nenit 43 të KPRK-së. E nëse personi i dënuar e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata mundet, me pëlqimin e të akuzuarit, në vend të shqiptimit të dënimit me burg, të e zëvendësojë dënimin me gjobë me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Urdhri për punë të përgjithshme llogaritet ashtu që tetë (8) orë të punës në dobi të përgjithshme llogariten me njëzetë (20) € gjobë, kjo mundësi e tillë e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.5. të KPRK-së.

Detyrohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej **20 €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarrimit me dhunë.

Detyrohet i akuzuari, që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej **20 €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarrimit me dhunë.

Detyrohet i akuzuari që të dëmtuarës KEDS Distrikti në Prishtinë, në emër të realizimit të kërkesës pasurore juridike për kompensimin e dëmit të shkaktuar më këtë vepër penale, të ia paguaj shumën prej **114.22 €**, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr.4897/2020, datë.30.12.2020, ka akuzuar të akuzuarin për vepër penale Vjedhja e shërbimeve, të parashikuar nga neni 314 par.6. lidhur me par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), po ashtu ka ushtruar kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor dënim me gjobë pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor PP.II.nr.4897/2020, datë.30.12.2020, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal që e vërtetojnë kryerjen e kësaj vepër penale nga i akuzuari.

Gjykata gjatë shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë për dhënien e urdhërit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, dënim me gjobë, në vështirësi të nenit 495 par.1. të KPP-së.

Gjykata duke i vlerësuar provat materiale të bashkangjitura në shkresat e lëndës dhe atë: kallëzimi penal me nr. të rastit CMS-K/DPR-640, i dt.22.09.2020, procesverbali i KEDS-it me

nr.90080318, i dt.15.07.2020, fotografitë nga vendi i ngjarjes-dhjetë foto, kalkulimi i rikthimit të humbjeve nga KEDS me ID të rastit 310584, dt.29.07.2020 dhe fatura DPRHP2029993, dt.29.07.2020, konstaton se këto prova janë bindëse dhe të bazuara dhe njëkohësisht vërtetojnë se i akuzuari ka kryer vepër penale Vjedhja e shërbimeve, të parashikuar nga neni 314 par.6. lidhur me par.1. të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), për të cilën vepër penale është i paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në 3 (tre) vite, ashtu që gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe e dënoi me gjobë në shumë prej 140 (njëqind e dyzetë) €, (nëse i akuzuari në afatin e caktuar nuk dëshiron ose nuk mund të paguaj gjobën, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burg në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) ditë, kur dënim me burgim zëvendësohet me dënimin me gjobë, njëzetë (20) € gjobë llogaritet barabartë me një ditë burgim, kjo mundësi e zëvendësimit është e bazuar në dispozitën e nenit 43 par.3. të KPRK-së), me bindjen se ky dënim me gjobë është në përputhshmëri të plotë me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe përgjegjësin penale të akuzuarit, dhe se i njëjti dënim do të ndikoi që të parandaloi të akuzuarin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e të dëmtuarës për dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, çka është edhe qëllimi i tij i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Vendimin që i akuzuari të paguaj në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 €, gjykata e bazoi në nenin 449 par.2.6. dhe par.3. të KPP-së, duke pasur parasysh zgjatjen dhe ndërlikueshmërinë e procedurës dhe gjendjen financiare të akuzuarit.

Vendimin që të detyrohet i akuzuari që për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj taksën në shumë prej 20 €, gjykata e bazoi në nenin 36 par.3. nënpar.3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit, ku është paraparë se gjyqtarët me rastin e shqiptimit të sanksioneve penale për veprat penale të përcaktuar në nën paragrafi 3.1. të këtij paragrafi caktojnë edhe taksat për kompensimin e viktimave si në vijim: për veprat penale që gjykohen nga Departamenti i Përgjithshëm i Gjykatës Themelore në shumë prej njëzet (20 €).

Vendimin që të detyrohet i akuzuari që të dëmtuarës KEDS Distrikti në Prishtinë, në emër të realizimit të kërkesës pasurore juridike për kompensimin e dëmit të shkaktuar me këtë vepër penale, të ia paguaj shumë prej 114.22 €, këtë në afat prej 15 ditë, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kanosjen e përmbartimit me dhunë, gjykata e bazoi në nenin 462 par.2. të KPP-së, pasi që të dhënat e mbledhura në procedurë penale paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë të kësaj kërkesë.

Nga e lartëheksuara është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA NË GLLOGOC
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI PENAL
P.nr.174/2023, datë:05.03.2024

Procesmbajtësja
Elheme Kastrati

G j y q t a r i
Shefqet Baleci

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 496 par.2. të KPP-së. i akuzuari mund të ushtrojë kundërshtim në afat prej 8 ditë, nga dita e pranimit dhe kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate. Nëse kundërshtimi nuk hudhet për shkaqe të arsyeshme, atëherë gjykata do të caktoi mbajtjen e shqyrtimit gjyqësorë sipas aktakuzës së ushtruar. Nëse nuk paraqitet kundërshtimi apo paraqitet pas afatit, urdhëri ndëshkimorë merrë formën e prerë dhe ekzekutohet.